

TRADITA E TATUAZHIT (E KËNOSJES) NE KRAHINËN ETNOGRAFIKE TE GORËS

Tatuazhi: (Kënosja)

Është një traditë mijra vjeçare që konsiston në lyerjen dhe pikturimin me ornamente të ndryshme të fytyrës, duarëve dhe këmbëve të vajzave, nuseve dhe grave me ngjyres natyral që përfitohen nga lëmisheqet, lëkura e durëve, e bardha e vezës, oksidet e ndryshme etj, vajzat dhe gratë kënosin vetëm duarët dhe këmbët, kurse nuset në ditën e martesës së tyre kënosin duarët, këmbët dhe fytyrën. Riti i kënosjes bëhet një ditë para se vajza të dalë nga gjinia, atë e bëjnë gra që i zotrojnë këto praktika, Ato në popull njihen si “telake” (telosëse që e rregullojnë nusen me tela varaku) ose mbarëstore (“Majmarica”) Duke qënë se e gjithë vëmendja e dasmës së vajzës përqëndrohet në paraqitjen e sajë sa më bukur. Dasma e vajzës emërtohet “Këna” dhe të grishurit për përcjelljen e saj emërtohen kënar (meshkujt) dhe kënagjesha (femrat). Lashtësia e këtij riti konfirmohet me një pikturim në gurë që është gjetur në Mikenë.

.....



“Në këtë figurë, sipas një pikturimi të lashtë mbi një guri gëlqeror i gjetur në Mikenë rreth -1500 para krishtit, shifen tatuazhet në fytyrë, vërehët se, këto katër pika, në dy faqet si dhe një në ball e tjetra në mjekërr, na i kujtojnë edhe tatuazhet tek ne në disa vise malore, por, mos të harrojm se, tatuazhe të ngjajshëme bënin edhe vashat vëllehe në Shqipëri e Maqedoni gjatë pushtimit osman, pra vashat vëllehe bënin tatuazhe ku figuronte një kryq në ball, shenjë për tu mbrojtur nga ushtarët turq, ishte një simbol mbrojtës ndaj dhunës, mirëpo tatuazhin e bënin edhe në të gjithë gishtat e duarve; Të njëjtat tatuazhe i hasim sot ende edhe tek popullsija bërbére (mendoj kabilé) në viset malore të Algjerisë që kanë lidhje edhe me astronomi e bestytni tjera, pra lidhje planetare ku i tërë tatuazhi mbi fytyrë


interpretohet si një hartë kozmose me të gjitha planetet e që lidhet me ditët e javës”...¹

Kjo traditë e stërlashtë është konservuar dhe ruhet akoma tek Pomakët, në Bullgari, Torbeshët në Maqedoni, Goranët në malet e Sharrit dhe torbeshët e Zhupës së Prizrenit. Praktikohet edhe sot në këto anë. Si e tillë nuk u ka shpëtuar studjuesve dhe krijuesve të ndryshëm. Piktori Tiranas Fadil Pullumi i angazhuar nga qeveria shqiptare për promovimin e turizmit shqiptar në vitin 1940 ka realizuar pikturën “Goranja” e cila ka qarkulluar si kartolinë gjatë viteve 1940-1945. Ku evidentohet kënjaja mbi duarët e vajzës, Gorane.




“Goranja”, (1940) punim i piktorit Fadil Pullumi (1918-1977)

¹ Postimi origjinal është bërë nga Kreksi = Qytetrimi Egjeanë Linearet A dhe B.



Mbarëstoret (Majmarice) gjatë Kënosjes së duarëve dhe këmbëve, Brod 1956



Mbarëstoret duke realizuar tatuazhin në fytyrën e vajzës në ditën e martesës



Pas përfundimit të tatuazhit, veshjes dhe telosjes nusja pozon para kënaqeshave



Dy motive të kënas mbi duarë




Tatuazh mbi fytyrë me motive të ralizuar në Gorë



Mbarstorët Pomake (Rodope Bullgari) duke bërë tatuazhin në fytyrën e nuses



Dy variante të tatuazhit tek nuset pomake në Rodope të Bullgarisë



Në vitin 2012, në Muzeun Etnologjik të Prizrenit është organizuar Java Artizanteve. Në ditën tretë, vizitorët kanë pasur rastin të shohin një traditë të lashtë të lyerjes së fytyrës që e praktikojnë gratë boshnjake (Torbeshe) të vendbanimit kufitar të Zhupës. Kjo është një traditë e lyerjes së nuseve për ditën e martesës.

Kjo traditë në vitin 2012 kishte bërë bujë në gjithë botën. Një video e xhiruar nga regjisori Yll Çitaku dhe Nita Deda për këtë traditë të lyerjes së fytyrës së nuseve në rajonin e Prizrenit e realizuar në kuadër të ngjarjes “One Day on Earth” (Një Ditë në Botë) kishte hyrë në një video me tregimet nga e gjithë globi. Madje nusja e pikturuar nga Kosova kishte marrë vëmendjen e shumë mediave të njohura si CNN duke e transmetuar këtë traditë si një nga më uniket në botë²




Nusja me tatuazh; Donje Lubinje, Prizren, Zhupa, Kosova e Jugut

² National Geographic ~Nuset e pikturuara në Kosovë

Një nuse Kosovare-Boshnjake (torbeshe), Senita Demirovic, e pikturoar nga një grua në fytyrë në ditën e martesës për një ceremoni tradicionale në fshatin Donje Ljubinje, Kosovë. Tradita, origjina e së cilës është më e lashtë se sa kujtesa e gjallë, konsiderohet nga pothuaj tërë banorët si identiteti i vecantë i vendit. Nusja e ka fytyrën të lyer për të parandaluar fatin e keq në ditën e dasmës. Donje Lubinja gjendet në malet e Sharrit në kufi mes Kosovës dhe Maqedonisë. Banorët e quajnë veten “Torbesh”.

Procesi i këtij grimi kërkon që fytyra së pari të lyhet me krem të bardhë, ndërsa më pas bëhen vija me pluhur nga ari dhe vizatohen rrathët si simbol i qiellit.



Më pas fytyra e nuses pikturohet me shumë ngjyra në shtresa të mrekullueshme ngjyrash. *Tre rrathët e artë simbolizojnë ciklet e jetës, të lidhur njëri me tjetrin nëpërmjet linjave të arta, të cilat njeriu i kalon në kohëzgjatjen e jetës së vet. Rrathët e brendshëm të kuq, janë simbolet e pjellorisë, prej nga ku pikat e kuqe dhe blu lindin dhe e tërë fytyra mbulohet prej tyre, duke i uruar asaj (nuses) një familje të lumtur e të shëndetshme.*

Pasi lyerja e fytyrës përfundon nusja vishet me rroba tradicionale nga boshnjakët (torbeshët) e anës së Prizrenit dhe nuk guxon as sytë t’i hapë.

-Këna e Gurit është lloji i kanës më të vjetër që njihet në traditën e lashtë. Të banorëve të Gorës. Ky lloj i kanës gjendet në gur në shtresën e sipërme të tijë, ka ngjyrën e gjelbërt. Këtë shtresë e zbusin me pak ujë aty në gurë dhe e shfritëzojnë si këna. Në disa katunde ka emërtime Guri i Kënës.

Këtë këna gratë dhe nuset e kanë shfrytëzuar gjatë ditëve të punës në fushë, kur kanë mbledhur barin - sanën, gjatë korrjes të thektrit, tërshërës,


nga guri për me shfrytëzuar për shitje edhe për ngjyrosje gjatë stinës së dimrit.

Këna e sheqerit; sheqerin e kanë djegur në tavë deri sa e ka marrë ngjyrën e kuqëremtë në të zezë. Sheqerin e djegur e kanë tretur deri sa është bërë qullë. Qullin e fituar e kanë shfrytëzuar për ngjyrosje.

Këna e arrës është shfrytëzuar gjithë dhe lëvozhga e frutit. Gjethet dhe lëvozhgën e kanë shfrytëzuar të njoma dhe të thara. Ngjyrosja e duarëve e flokeve dhe gishtave të këmbëve është bërë edhe pas natës së kënas, në ditët e festave kombëtare, fetare, familjare dhe ditëve të rëndomta. Plakat kanë ngjyrosur gishtat e të dy duarëve nga gjysma e gishtave e lartë nga thonjtë dhe në pëllëmbë kanë vendosur një pike të madhe dhe rrethë e rrotull pëllëmbës kanë vendosur pika të vogëla por tek.

Kjo ngjyrosje është quajtur pula me zogjë. Pra fëmijët, të afërmit e familjes të jenë të gjithë bashkë dhe të gjithë të respektojnë kryefamiljarin – të zotin e shtëpisë dhe anasjelltas i zoti shtëpisë të jetë i kujdesshëm për të gjithë anëtarët e familjes. (uaaaa si i mbështjell si pula zogjtë).

Nuset dhe gratë i kanë ngjyrosur gishtat dhe anën e sipërme të duarëve. Më parë me pej i kanë lidhur duartë si pas dëshirës se si do dukej ngjyrosja, pas mesa e kanë vendosur këna. Vajzat s'kanë përdorur këna as në duar e as në flokë, sepse ata skanë nevojë për zbukurim se vet atyre zoti ju ka falur bukurin. Vajzat e kanë ngjyrosur vetëm gishtin e voguë të dorës së djathtë natën e kanë për me i dalë fati më shpejtë.



Punuar nga: Elmaz Dokle
Nentor,2015